



QF-A-018

**PLANI FINANCIAR
I FONDIT TË SIGURIMIT TË DEPOZITAVE
PËR VITIN 2023**

Shkup, janar 2023

PËRMBAJTJA

I.HYRJE.....	3
I. Skenari makroekonomik për vitin 2023 në Republikën e Maqedonisë së Veriut	Error!
Bookmark not defined.	
II. Bazat e Planit financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2023	5
II.1 Dinamika e planifikuar e lëvizjes së bazës së depozitave në Fond në pjesën e mejteve të popullatës gjatë vitit 2023	6
II.2 Dinamika e planifikuar mujore e lëvizjes së depozitave dhe gjendja e portofolit investues eRe Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023.....	9
III. Rezultate të bilancit të planifikuar të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2023.....	12
III.1 Gjendja e bilancit	Error! Bookmark not defined.
III.2 Plani i Bilancit të suksesit për periudhen prej 01.01 deri më 31.12.2023.....	Error!
Bookmark not defined.	

I. HYRJE

Fondi i Sigurimit të Depozitave është institucion shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i themeluar në 1997 me ligj të veçantë dhe funksionon si një institucion financiar jo-buxhetor, vetë-financues, fitimprurës, institucion financiar i specializuar. Qëllimi i ekzistimit të Fondit është sigurimi i depozitave të popullsisë dhe dëmshpërblimi i depozitave të siguruara në banka, degë të bankave të huaja, shtëpi kursimesh në rast të ndodhjes së një ngjarjeje të rrezikshme. Fondi është regjistruar me veprimtari në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare (65.12 sigurime jo-jetësore).

Detyra kryesore e Fondit është të sigurojë depozitat e popullsisë në sektorin bankar në vend dhe të disponojë me ndërgjegje dhe produktivitet me mjetet të cilat i mbledh nga bankat, degët e bankave të huaja dhe shtëpitë e kursimeve në bazë të premive për sigurimin e depozitave, me çka mundëson shtimin e mjeteve dhe forcimin e vazhdueshëm të fondeve të sigurisë, të cilat përdoren për të dëmshpërblyer depozituesit në rast se Guvernatori i Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut merr lejen e punës për një bankë, degë të një banke të huaj ose shtëpi kursimi, dmth. në rast të ndodhjes së një ngjarjeje rreziku.

Fondi i Sigurimit të Depozitave është një nga shtyllat më të rëndësishme në ruajtjen e stabilitetit financiar, së bashku me institucionet e tjera që marrin pjesë në krijimin dhe drejtimin e politikës fiskale dhe monetare të vendit. Prandaj, pjesëmarrja e tij në analizat sistematike është e rëndësishme, parashikimet dhe simulimet e ngjarjeve të mundshme me rrezik me qëllim që të garantojë sigurinë e depozitave të qytetarëve.

Plani Financiar i Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023 u krijua me qëllim që të organizojë dhe zbatojë në mënyrë efikase aktivitetet që janë të rëndësishme për realizimin e dy proceseve bazë për të cilat u themelua Fondi, si dhe me qëllim të modernizimit të tyre, për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e shërbimeve të Fondit. Gjatë vitit 2023, Fondi do të vazhdojë të zbatojë aktivitete promovuese që do të kontribuojnë në ngritjen e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimin e publikut për ekzistencën e një sistemi të sigurimit të depozitave, i cili do të forcojë besimin në sistemin bankar, i cili është shtyllë e zhvillimit të ekonomisë në shtet.

Investimet, si një nga aktivitetet kryesore të Fondit, do të vazhdojnë të zbatohen në përputhje me politikat e investimeve për ruajtjen e një portofoli investimesh të fortë, me rrezik të ulët dhe portofol investues të sigurt.

Gjatë vitit 2023, Fondi do të vazhdojë të përforcojë bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, Forumin Evropian të Siguruesve të Depozitave dhe Shoqatën Ndërkombëtare të Siguruesve të Depozitave. Gjithashtu është planifikuar ruajtja e bashkëpunimit të suksesshëm me të gjitha institucionet dhe organizatat e rëndësishme vendase në sektorin financiar dhe

bankar. Fondi i Sigurimit të Depozitave do të punojë në aktivitete që korrespondojnë me politikat e reja evropiane të sigurimit të depozitave

Qëllimi përfundimtar i të gjitha aktiviteteve të cilat i zbaton Fondi është përforsimi dhe modernizimi i sistemit të sigurimit dhe dëmshpërblimit të depozituesve si dhe afrimi me Direktivën Evropiane për Sigurimin e Depozitave (DIREKTIVA 2014/49 / EU).

Për realizimin e aktiviteteve afariste, gjatë përgatitjes së Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023, janë marrë parasysh parametrat e mëposhtëm:

a) legjislacioni aktual; b) Politikat ekonomike të Qeverisë, treguesit makroekonomik dhe parashikimet për vitin 2023; c) përforsimin e bashkëpunimit rajonal dhe bashkëpunimit me shtetet e zhvilluara evropiane me qëllim të përafrimit me trendet evropiane; d) përforsimin e bashkëpunimit me BPRMV, Ministrinë e Financave, Shoqatën e Bankave të Maqedonisë dhe institucione të tjera financiare dhe bankare të rëndësishme për ruajtjen e stabilitetit financiar në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Skenari makroekonomik për vitin 2023 në Republikën e Maqedonisë së Veriut

Parashikimet botërore për rritje të ekonomisë globale për vitin 2023 nuk janë të favorshme, veçanërisht për arsye të konfliktit aktual në Ukrainë i cili filloi në shkurt të vitit 2022.

Si pasojë e këtij konflikti është edhe kriza energjetike në eurozonë, politikat restriktive monetare, ulja e besimit dhe forcës blerëse të popullatës. Të gjitha projektimet për rritje janë në ulje dhe lidhen me shpërndarjen e ulët të energjisë dhe ushqimit.

Pa rënies së PBB-së prej -6,1% në vitin 2020, dhe lëvizjet pozitive në vitin 2021 kur PBB-ja paraqet 4,2%, gjatë vitit 2022 përsëri shënohet rritje e ulët e PBB-së i cili parashikohet se do të arri 3,2% në fund të vitit 2022 ¹. Nga ana tjetër, ekonomija maqedonase ballafaqohet me shkallën më të madhe të inflacionit në 30 vitet e fundit dhe e njeta në tre mujorshin e tretë të vitit 2022 paraqet 17,2%.për shkak të gjendjes së këtillë, Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut e shtërgon politikën monetare me qëllim që të sigurohen kushte për ngadalsimin ose ndalimin e të njetit.

Në pajtim me skenarin themelor makroekonomik, rritja ekonomike në vitin 2023 është projektuar të jetë 2,9%. Rritja e aktivitetit ekonomik edhe mëtej do të jetë e nxitur nga kërkesa vendase. Inflacioni do të filloj të zvogëlohet vitin e ardhshëm, por çmimet për energji dhe ushqim në tregjet ndërkombëtare do të jenë më të mëdha, për këtë arsye shkalla e projektuar është 7,1%².

Institucionet financiare ndërkombëtare parashikojnë ngadalsim të inflacionit për vitin e ardhshëm. Fondi monetar ndërkombëtar pret ngadalsim të shkallës së inflacionit për ekonominë globale dhe atë të vendit tonë³.

¹ Burimi: Mministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

² Burimi: Mministria e Financave e Republikës së Maqedonisë së Veriut

³ Burimi: Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

Në projektimin e Planit financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023, më të rendësishme janë lëvizjet e depozitave të popullatës të cilat i siguron dhe dëmshpërblen Fondi i Sigurimit të Depozitave, ndërsa parasysh janë marrë edhe faktor të tjerë dhe atë:

- Parashikimet për zhvillimet makroekonomike dhe politikën monetare në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023;
- Dinamika e planifikuar e lëvizjes së depozitave të popullatës në sektorin bankar në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2023;
- Dinamika e planifikuar mujore e lëvizjes dhe gjendja e portofolit të investimeve të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023;
- Rezultatet e vlerësuara të bilancit në vitin 2023.

Gjatë vitit 2023, Fondi i Sigurimit të Depozitave do të vazhdojë të kryejë aktivitetet e rregullta afariste përmes të cilave realizohen qëllimet e tij themelore, strategjitë dhe misioni për të cilin është krijuar, duke marrë parasysh zbatimin e masave dhe aktivitetëve për një funksionim efikas dhe efektiv, evaliumin e qëllimeve të arritura dhe vendosja e një shkalle të lartë të kontrollit mbi punën. Njëkohësisht, Fondi i Sigurimit të Depozitave planifikon të kryejë aktivitete të caktuara përgatitore në mënyrë që të afrohet me politikat e reja të BE-së në fushën e sigurimit të depozitave të popullatës.

II. Bazat e Planit Financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2023

Gjatë përgatitjes së Planit financiar të Fondit të Sigurimeve, u marrë parasysh gjendja e depozitave sipas muajve, dinamika e lëvizjes së depozitave, struktura e monedhës dhe struktura e maturimit të depozitave të popullatës në sektorin bankar në vitin 2022, në bazë të së cilit ishte përgatitur parashikim për dinamikën e lëvizjes së depozitave të popullatës në vitin 2023.

Projeksioni i caktuar i lëvizjes së depozitave të popullatës për sektorin bankar në vitin 2023 mundësoi përgatitjen e një parashikimi relativisht të saktë të të hyrave në Fond gjatë vitit 2023 në bazën të mbledhjes së premeve të sigurimit, ndërsa parashikimi i të hyrave në Fond mundësoi planifikimin e investimeve të Fondit për vitin 2023.

Prandaj, plani financiar për vitin 2023 bazohet në parametrat e mëposhtëm:

- Depozitat e popullatës në sektorin bankar në fund të vitit 2023 do të arrijnë rritje vjetore prej 6.5% dhe do të arrijnë shumën prej 352,762 milion denarë;
- Fondi në fund të vitit 2023 do të mbledhë premijë totale vjetore në vlerë prej 848 milion denarë;
- Vëllimi i portofolit të investimeve (vlerë nominale) në fund të vitit 2023 parashikohet t'a

tejkalojë me 9.3% të vëllimit të realizuar në fund të vitit 2022 gjegjësisht vëllimi I portofolit investues (vlera aktuale) në fund të vitit 2023 parashikohet t'a tejkaloj për 8,9% të vëllimit të realizuar në fund të vitit 2022;

- Në bazë të kamatës për bonot shtetërore (normë interesi prej 3.5% në tre mujorin e parë; normë inters prej 3,2% në tre mujorin e dytë; normë interesi prej 3,0% në tre mujorin e tretë; normë interesi) në vitin 2022 Fondi do të realizojë 38,016 mijë denarë dhe, për bankat ndërmjetsuese do të paguajë provizion në vlerë prej 525 mijë denarë për ndërmjetësimin në blerjen e bonove.
- Shpenzime të projektuara të Fondit 36 milion denarë në vit dhe 46 milion denarë në vit në bazë obligimeve për pagesën e konotative të tatimit mbi fitimin e punës së Fondit.

Fondi i Sigurimit të Depozitave, në cilësinë e kredituesit në procedurën e falimentimit të „Eurostandard Bankë” SHA Shkup në falimentim, më 25.08.2022 ju realizua pagesë e pjeshme e kërkesës së vetë në shumë prej 1.457 miliardë denarë ose 36,86% nga totali i kërkuar. Gjatë realizimit të pagesës së kërkesave, Fondi menjëherë i deponoj mjetet në fondin e sigurisë dhe i përfëshin ata në mënyrë adekuade në portofolin e tij investues.

Parametrat e lartpërmendura janë elaboruar në mënyrë të detajuar në pjesën II.1 dhe II.2 të kapitullit II të Planit financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023.

II.1 Dinamika e planifikuar e lëvizjes së bazës së depozitave tek anëtarët e Fondit në pjesën e mjetëve të popullatës gjatë vitit 2023

Dinamika e planifikuar e lëvizjes së bazës së depozitave të anëtarëve të Fondit në vitin 2023 bazohet në vlerësime reale nga ana e Fondit dhe parashikohet rritja vjetore e masës së depozitës prej 6.5%, gjegjësisht depozitat e popullatës në total në fund të vitit 2023 të arrijnë në 352,762.390 mijë denarë (Tabela 1).

Tabela 1: Dinamika e planifikuar e rritjes së depozitave dhe bilanci i planifikuar mujor i depozitave totale të popullatës në vitin 2023 në korrelacion me bilancin e realizuar mujor të depozitave dhe dinamika e realizuar e rritjes së depozitave në vitin 2022

në mijëra denarë

Data	Depozita viti 2022 <i>gjendja reale</i>	Dinamika e planifikuar e rritjes së depozitave për vitin 2022 (në %)	Dinamika e realizuar e rritjes së depozitave në vitin 2022 (në %)	Data	Depozita të planifikuara për vitin 2023	Dinamika e planifikuar e rritjes së depozitave për vitin 2023
31.12.2021	316.667.657			*31.12.2022	331.290.047	
31.01.2022	316.409.193	0,20%	-0,08	31.01.2023	331.621.337	0,10
28.02.2022	317.918.225	1,30%	0,48	28.02.2023	333.279.444	0,50
31.03.2022	312.414.161	0,25%	-1,73	31.03.2023	333.946.003	0,20
30.04.2022	315.003.771	0,20%	0,83	30.04.2023	336.617.571	0,80
31.05.2022	315.725.794	0,50%	0,23	31.05.2023	337.627.423	0,30
30.06.2022	319.113.293	0,27%	1,07	30.06.2023	339.990.815	0,70
31.07.2022	320.699.738	0,35%	0,50	31.07.2023	341.690.769	0,50
31.08.2022	321.756.069	0,90%	0,33	31.08.2023	343.399.223	0,50
30.09.2022	324.999.315	0,44%	1,01	30.09.2023	345.116.219	0,50
31.10.2022	325.961.533	0,30%	0,30	31.10.2023	346.841.800	0,50
30.11.2022	326.394.135	0,60%	0,13	30.11.2023	349.269.693	0,70
*31.12.2022	331.290.047	1,50%	0,13	31.12.2023	352.762.390	1,00
Gjithsej		7%	4,6%			6,5%


* shuma dhe përqindja e rritjes së shprehur për muajin dhjetor viti 2022 jepen si pritje (projektim) për arsye se në momentin e përgatitjes së planit financiar për vitin 2023 nuk ka të dhëna reale të disponueshme për analizë.

Në pajtim me rritjen e realizuar të depozitave në vitin 2022 dhe indikatorëve makroekonomikë të treguar mësipër në vitin 2023, për vitin 2023 është projektuar rritje vjetore e bazës së depozitës prej 6.5%, e cila në baza mujore do të karakterizohet me rritje deri në fund të vitit 2022.

Trendi mujor i lëvizjes së depozitave në vitin 2022 dhe ai i planifikuari për vitin 2023 është dhënë në Grafikon1

Grafiku 1: Dinamika e depozitave të popullatës për vitin 2022 dhe projektimi i dinamikës së depozitave të popullatës për vitin 2023

Plani financiar i Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023



Në pajtim me lëvizjen e projektuar të depozitave për vitin 2023, parashikohet që Fondi të mbledhë shumën totale të premisë prej 848,060,489 denarë deri në fund të vitit 2023. (Tabela2).

Tabela 2: Mbledhja e pritshme e premisë nga anëtarët e Fondit dhe niveli i mbulimit të Fondit gjatë vitit 2023

në denarë

Data	Gjendja e parashikuar e depozitave gjatë vitit 2023	Norma e premisë (%)	Vlera mujore e premisë	Niveli i mbulimit (target ratio)
*31.12.2022	331.290.047.025			
31.01.2023	331.621.337.072	0,25	69.018.760	5,31
28.02.2023	333.279.443.757	0,25	69.087.779	5,31
31.03.2023	333.946.002.645	0,25	69.433.217	5,33
30.04.2023	336.617.570.666	0,25	69.572.084	5,32
31.05.2023	337.627.423.378	0,25	70.128.661	5,33
30.06.2023	339.990.815.342	0,25	70.339.047	5,32
31.07.2023	341.690.769.418	0,25	70.831.420	5,33
31.08.2023	343.399.223.266	0,25	71.185.577	5,34
30.09.2023	345.116.219.382	0,25	71.541.505	5,34
31.10.2023	346.841.800.479	0,25	71.899.212	5,35

30.11.2023	349.269.693.082	0,25	72.258.708	5,34
31.12.2023	352.762.390.013	0,25	72.764.519	5,32
Totali vjetor i premisë për vitin 2023			848.060.489	

*shuma e paraqitur për muajin dhejtor për vitin 2022 janë dhënë si preitje (projektimi) për arsye së në momentin e përgatitjes së planit financiar për vitin 2023 nuk ka të dhëna të disponueshme reale për analizë.

II.2 Dinamika e planifikuar mujore e lëvizjes dhe gjendja e portofolit të investimeve të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2023

Në përputhje me Ligjin për Fondin e Sigurimit të Depozitave edhe në vitin 2023, Fondi do t'i plasojë mjetet e mbledhura në letrat me vlerë – bono thesari me vlerë me afat maturimi prej 364 ditësh, sipas kalendarit të ankandëve mujore për vitin 2022, të shpallur nga Ministria e Financave. Mënyra e investimit të mjeteve bëhet sipas dispozitave të akteve të brendshme të Fondit - Rregullorja për politikën e investimeve të Fondit.

Gjatë përgatitjes së planit të portofolit të investimeve të Fondit për vitin 2023, u vërtetuan supozimet e mëposhtme:

- ❖ 6,5% rritje vjetore e depozitave të përgjithshme te anëtarët e Fondit;
- ❖ 0,25% norma vjetore e premisë; dhe
- ❖ 3,5% normë vjetore interesi bonove shtetërore 12-mujore në tre mujorin e parë, 3,2% normë vjetore interesi në tre mujorin e dytë, 3,0% normë vjetore interesi në tre mujorin e tretë, 2.9% normë vjetore interesi në tre mujorin e katërt, të vitit 2023
- ❖ Shpenzimet e Fondit në shumën prej 36 milion denarësh në nivel vjetor për funksionim operativ dhe 46 milion denarë në nivel vjetor në bazë të pagesës kontative të tatimit mbi fitimin e punës së Fondit.

Fondi do t'i plasojë mjetet në të holla nga pagesa e premisë nga anëtarët e Fondit dhe të ardhurat në bazë të plasmaneve në letra me vlerë.

Premia totale në vitin 2023 do të arrijë 848 mijë denarë, që paraqet hyrje bazë për ri-investim, gjegjësisht për blerjen e bonove të reja, së bashku me shumën e bonove të maturimit të arritur në secilin muaj të vitit. Në mënyrë shtesë në muajin shtator të vitit 2023, për arsye të përfundimit të detyrimit kontraktor me bankat paguese të depozitorëve të Eurostandard bankë pritet që të realizohet këthimi i meteve të papaguara të cilat ishin të planifikuara për dëmshpërblimin e depozitorëve të Eurostandard bankë të cilët ishin dërguar nga Fondi i Sigurimit të Depozitave në katër bankat paguese në shumë prej 339 milion denarë.

Gjendja e përgjithshme e portofolit të investimeve në fund të vitit 2023 planifikohet të arrijë në 18.870 milion denarë (vlera aktuale, 18.586 milion denarë), që paraqet rritje nominale prej

Plani financiar i Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023

1,590 milion denarë, gjegjësisht rritje nominale prej 9.3% krahasuar me vitin 2022 gjegjësisht rritje prej 8,9% (vlerë aktuale) krahasuar me vitin 2022. Dinamika dhe vlerat nominale të bonove shtetërore me afat maturimi të arritur dhe bonove shtetërore të planifikuara sipas muajve në vitin 2023 është treguar në Tabelën 3.

Tabela 3: Plani i portofolit të investimeve të Fondit për vitin 2023

në denarë

- 2023 година (месеци) - 12 месечни државни записи	Достасани записи	Нови записи	Каматна стапка	Камата			Провизија за банка- купувач
	<i>во номинална вредност</i>			<i>камата до 31.12.2023</i>	<i>камата во 2024</i>	<i>вкупно камата до доспевање</i>	
состојба на 31.12.2022	17.280.000.000						
јануари	660.000.000	760.000.000	3,50%	25.262.413	713.627	25.976.040	35.000
	17.380.000.000						
февруари	830.000.000	920.000.000	3,50%	28.161.994	3.282.686	31.444.680	35.000
	17.470.000.000						
март	3.120.000.000	3.260.000.000	3,50%	93.363.131	18.060.409	111.423.540	35.000
	670.000.000	730.000.000	3,50%	18.987.186	5.963.484	24.950.670	35.000
	17.670.000.000						
април	1.300.000.000	1.410.000.000	3,20%	31.929.074	12.261.736	44.190.810	35.000
	17.780.000.000						
мај	1.100.000.000	1.200.000.000	3,20%	24.280.665	13.328.535	37.609.200	35.000
	17.880.000.000						
јуни	600.000.000	680.000.000	3,20%	11.882.027	9.743.263	21.625.290	35.000
	17.960.000.000						
јули	120.000.000	190.000.000	3,00%	2.643.130	2.950.470	5.593.600	35.000
	18.030.000.000						
август	450.000.000	530.000.000	3,00%	6.430.521	9.131.339	15.561.860	35.000
	18.110.000.000						
септември	1.550.000.000	1.660.000.000	3,00%	15.574.084	33.296.316	48.870.400	35.000
	18.220.000.000						
октомври	820.000.000	1.150.000.000	2,90%	7.200.584	25.472.066	32.672.650	35.000
	1.590.000.000	1.640.000.000	2,90%	8.599.317	38.119.363	46.718.680	35.000
	18.600.000.000						
ноември	2.300.000.000	2.400.000.000	2,90%	8.640.013	59.728.787	68.368.800	35.000
	1.040.000.000	1.110.000.000	2,90%	2.779.830	28.840.740	31.620.570	35.000
	18.770.000.000						
декември	1.130.000.000	1.230.000.000	2,90%	1.732.698	33.306.312	35.039.010	35.000
	18.870.000.000						
Вкупна состојба на 31.12.2023	18.870.000.000			287.466.667	294.199.133	581.665.800	525.000
Сегашна вредност на 31.12.2023	18.298.334.200			18.585.800.867			

Në bazë të plasmaneve të reja në bonot shtetërore me normë vjetore interesi prej 3.15%, gjegjësisht normë interesi prej 3,5% normë vjeore interesi e bonove shtetërore 12- mujore për tre mujorin e pare, 3,2% normë vjetore interesi në tre mujorin e dytë, 3,0% normë vjetore interesi për tre mujorin e tretë, 2, 9% normë vjetore interesi në tre mujorin e katërt të vitit 2023, Fondi

Ул. „11 Октомври“ бр.18
1000, Скопје
Република Северна Македонија

тел: 02 32 35 730
факс: 02 32 96 901
info@fodsk.org.mk
www.fodsk.org.mk

Rr. “11 Tetori” nr.18
1000, Shkup
Republika e Maqedonisë së Veriut
tel: 02 32 35 730
факс: 02 32 96 901
info@fodsk.org.mk
www.fodsk.org.mk

do të mbledh kamatë në vlerë prej 287.466.667 denarë, dhe do të paguajë provizion për bankat ndërmjetsuese për ndërmjetësimin e kryer gjatë blerjes së bonove në shumë prej 525 denarë.

*Norma e interesit e bonove shtetërore është e paraparë në përputhje me projektimet e Ministrisë së Financave në momentin e përgatitjes së Planit financiar të Fondit të Sigurimit të Depozitave për vitin 2023.

Tabela 4: Përmbledhje e planit të të ardhurave të interest(kamatës) në bazë të bonove shtetërore dhe provizionit për ndërmjetësimin për blerjen e bonove në 2023

<i>në denarë</i>		
P Ë R S H K R I M	Gjendja	
1.Gjendja e bonove shtetërore (bonot shtetërore 12 mujore)	Vlera normale	Vlera aktuale
Gjendja e bonove shtetërore ne vitin 31.12.2022	17.280.000.000	
Bonot e reja shtetërore në vitin 2023	1.600.000.000	
Gjendja e bonove shtetërore në vitin 31.12.2023	18.880.000.000	18.298.334.200
2.Interesi në baze të bonove shtetërore	viti 2023	viti 2024
2.1. Interesi në bazë të bonove të paarritura nga viti 2022	214.069.474	
2.2. Interesi në bazë të bonove të reja për vitin 2023:		
- Interesi i bonove me afat maturimi në vitin 2023	287.466.667	
- Intersi (kamatë)i bonove me afat maturimi në vitin 2024		294.199.133
Interesi total 2023 :	501.536.141	
3.Provizion për blerjen e bonove të thesarit shtetëror	525.000	

Në përputhje me Rregulloren për politikën e investimeve të Fondit, shuma totale e portofolit të investimeve të Fondit në fund të çdo muaji nuk do të kalojë 99% nga shuma e gjendjes së mjeteve të përgjithshme, gjendjes së letrave me vlerë të Fondit dhe kërkesave në bazë të premive. Nën gjendjen e letrave me vlerë merret përputhja e vlerës së bonove shtetërore në evidencën e kontabilitetit të Fondit (gjendja aktuale) në fund të çdo muaji. Investimi i mjeteve bëhet përmes llogarisë së Fondit në BPRMV.

Shuma e gjendjes së plasmanëve në letrat me vlerë dhe gjendja e mjeteve likuide në llogarinë e Fondit paraqet element për përcaktimin e nivelit të synuar (proporcioni i synuar, objektivi(targeti)) të Fondit, gjegjësisht krahasimi i tij me depozitat e përgjithshme në banka dhe shtëpi kursimesh, anëtare të Fondit, të cilat në vitin 2022 planifikohet të lëvizin prej 5,31% në janar,2023 deri në 5,32% në dhjetor të vitit 2023.

III. Rezultatet e planifikuara të bilancit të Fondit të Sigurimit të Depozitave në vitin 2023

Aktiviteti afarist i Fondit prezentohet përmes projektimit të rezultateve të bilancit që pritet të realizohen në fund të vitit 2023. Një nga qëllimet kryesore të Fondit është rritja e fitimit në mënyrë që të sigurojë burime financiare të nevojshme për të shtuar kapacitetin e Fondit në kryerjen e funksionit të tij themelor, sigurimi i depozitave të popullatës dhe dëmshpërblimin e depozituesve në rast të një ngjarjeje të rrezikshme të njëra nga anëtarët - bankat dhe shtëpitë e kursimit.

Në përputhje me parashikimet për zhvillimet makroekonomike dhe drejtimeve të politikës makroekonomike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2023, sipas kalendarit për ankandet e bonove shtetërore të organizuara nga Ministria e Financave, si dhe nevojave të parashikuara të Fondit për veprimtari të papenguar të aktivitetit afarist janë projektuar vlerat sipas kategorive në Bilancin e gjendjes dhe Bilancin e suksesit të Fondit për vitin 2023.

III.1 Bilanci i gjendjes

Bilanci i përgjithshëm në fund të vitit 2023 pritet të arrijë në 18,823 milion denarë.

Projetimi për bilancin e përgjithshëm në fund të vitit 2022 paraqet 17.555 milion denarë . Rritja e planifikuar prej 1.127 mijë denarë ose 7,23%. Rritja e planifikuar i bilancit është kryesisht për shkak të pjesëmarrjes së bonove shtetërore në strukturën e përgjithshme të mjeteve.

1. Struktura e mjeteve në planin e Bilancit të gjendjes më 31.12.2023

Strukturën e mjeteve në gjendjen e Bilancit e përbëjnë katër grupe të kategorive të mjeteve:

1.1 "Mjetet jomateriale ", programet softuerë të nevojitura për kryerjen cilësore të veprimtarive afariste;

1.2 "Mjetet materiale" që përfshijnë vlerën e hapësirës afariste personale së bashku me pajisjet(mjete bazë) me të cilat realizohet veprimtaria e afariste e Fondit të Sigurimit të Depozitave;

1.3 "Investime" që mbahen deri në skadim dhe që përbëjnë portofolin e investimeve të Fondit; dhe

1.4 "Mjetet në të holla, kërkesa, përkufizim" që përfshin mjetet që mbahen në BPRMV, në bankat komerciale për nevoja operative dhe në arkën e Fondit. Në të njëjtën kohë, në këtë grup janë përfshirë edhe kufizimet aktive kohore.

Vlerat sipas kategorive të mjeteve nga ana e aktivitetit janë paraqitur në Tabelën 5.

Tabela nr.5 Struktura e mjeteve në plan të gjendjes së Bilancit

në mijëra denarë

Përshkrim	Plani 31.12.2022	%	Gjendja 31.12.2022	%	Plani 31.12.2023	%	Indeksi 6/4
1	2	3	4	5	6	7	8
MJETE	16.049.845	100,00	17.554.891	100,00	18.795.911	100,00	107,07
<i>Mjete jomateriale</i>	2.099	0,01	0	0,00	467	0,00	0,00
Softuer dhe të drejta të ngjajshme	2.099	0,01	0	0,00	467	0,00	0,00
<i>Mjete materiale</i>	18.990	0,12	18.122	0,10	18.252	0,10	100,72
Patundshmëri	17.836	0,11	17.836	0,10	17.027	0,09	95,46
Paisje	1.154	0,01	286	0,00	1.225	0,01	428,32
<i>Investime</i>	15.579.448	97,07	17.066.183	97,22	18.585.801	98,88	108,90
Bono dymbëdhejtë mujore	15.579.448	97,07	17.066.183	97,22	18.585.801	98,88	108,90
<i>Mjete në të holla, kërkesa, përkufizime</i>	449.308	2,80	470.586	2,68	191.391	1,02	40,67
Mjete materiale (para)	447.458	2,79	465.632	2,65	191.391	1,02	41,10
1. Të holla në banka	447.388	2,79	465.583	2,65	191.356	1,02	41,10
2. Kartela afariste	50	0,00	25	0,00	25	0,00	100,00
3. Arkë	20	0,00	24	0,00	10	0,00	41,67
Kërkesa	1.850	0,01	4.954	0,03	0	0,00	0,00
1. Kërkesa në bazë të premive	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0,00
2. Kërkesa të tjera	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0,00
3. Akonotacione të tatimit mbi fitimin	1.850	0,01	4.954	0,03	0	0,00	0,00
Përkufizime	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0,00
1.AVR	0	0,00	0	0,00	0	0,00	0,00

1.1 Mjetet jo materiale

Në kategorinë "mjete jomateriale" janë të pëfshira softueri dhe ueb faqja e internetit të Fondit. Për vitin 2023 vlera e përgjithshme e mjeteve jomateriale planifikohet të jetë 467 mijë denarë.

Në vitin 2023 është i nevojshëm furnizimi i 16 licencave për systemin operativ Misrosoft dhe Microsoft Office 365. Prej tyre 13 licenca do të përdoren për kompjuterët e rid he 3 për kompjuterët personal .

1.2 Mjete materiale

Kategoria "mjete materiale" paraqet hapsirën afariste, në pronësi të Fondit në të cilin kryhet veprimtaria afariste. Sipas planit për vitin 2023, vlera e tij në fund të vitit 2023 pritet të jetë 18,230 mijë denarë ose rritje në vlerë prej 0,6%.

Në kategorinë e mjeteve materiale përfshihet vlera e pajisjeve. Vlera e pajisjeve ekzistuese bie në përputhje me llogaritjet e amortizimit.

Vlera e përgjithshme e pajisjeve planifikohet të jetë 1.225 mijë denarë.

Në vitin 2023 planifikohet furnizim me:

- 13 kompjuter të ri personal (650 mijë denarë)
- Inventar zyre – 6 tavolina (105 mijë denarë) dhe 10 karrige (80 mijë denarë)
- Rinovimi I mobiljeve në zyrën për pranimit(të palëve) për arsye të vjerësisë së atyre ekzistuese- (180 mijë denarë)
- 4 ruter bashkë me montimin dhe lidhjen e tyre, në vlerë totale prej 60 mijë denarë
- 1 fotokojues (100 mij denar)
- 6 printer të ri (36 mijë denar)
- 5 kondicioner të ri (150 mijë denar)

Vlera e paisjeve e cila do të blihet gjatë vitit 2023 do të amortizohet deri në 31.12.2023.

1.3 Investimet në letrat me vlerë të cilat ruhen deri në maturim

Në strukturën e Bilancit, në anën e aktivës edhe gjatë vitit 2023, pjesëmarrje dominuese prej 98.88% është planifikuar të ketë kategorinë e mjeteve "investime në letra me vlerë" (gjendja për 31.12.2022: 97,22%). Të njëjtit planifikohet të rrisin vëllimin për 1.549 mijë denarë (vlerë aktuale) ose 9,08% krahasuar me vëllimin e parashikuar në fund të vitit 2022 si rezultat i politikës së vendosur të investimeve prej 99%.

1.4 Mjete monetare, kërkesa, përkufizme

